



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2015
Nr. Dok. 201501580/10

Lënda : Rekomandohet *"Fillimi i hetimit te procedimit disiplinor ndaj punonjësve të policisë së NJ.F.P.O-së pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë, të cilët, më datë 10 Gusht 2015, kanë realizuar arrestimin e shtetasit E. A."*

Drejtuar : Drejtorit të Drejtorisë së Standarteve Profesionale
Z.Dylaver SHIMA

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

TIRANË

Për dijeni: Drejtorit të Drejtorisë së Policisë
Z.Ervin HODAJ

TIRANË

I nderuar Z. SHIMA,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja V. A., nga Tirana, e cila ka ngritur pretendimin se punonjësit e Policisë së Shtetit kanë ushtruar dhunë fizike gjatë arrestimit të djalit të saj E. A., ngjarje e ndodhur më datë 10 Gusht 2015. Shtetasja Vjollca Alimehmeti për këtë ngjarje, ka informuar dhe Ambasadën Amerikane në Tiranë, meqënëse djali i saj E. A., gëzon shtetësinë amerikane.

Mbi këtë shqetësim, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, i cili ka konsistuar në kërkesat për informacion drejtuar Komisarariatit të Policisë nr.2, Drejtorisë së Policisë Tiranë, administrimin e

dokumenteve, si dhe marrjen e deklarimeve të shtetasit E. A., në mjediset e I.E.V.Penale 302 Tiranë.

Kërkesës sonë për informacion i është përgjigjur menjëherë Komisarati i Policisë nr.2 Tiranë, duke e shoqëruar atë dhe me dokumentacionin përkatës. Ndërsa, Drejtoria e Policisë Tiranë shkresës sonë “Kërkesë për informacion” të datës 29.09.2015, i është përgjigjur me shumë vonesë dhe vetëm pas ndërhyrjes tuaj më datë 05.11.2015. Veç sa sipër, Drejtoria e Policisë Tiranë, në informacionin e dërguar nuk ka sqaruar se kush kanë qënë punonjësit e policisë të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë kryer arrestimin e shtetasit Erald Alimehmeti, si dhe nuk ka dërguar fotokopje të Raportit të Shërbimit të përpiluar prej tyre.

Rrethanat e ngjarjes

Në deklaratimet e tij shtetasi E. A., ka shpjeguar se në ditën e ngjarjes datës 09.08.2015, rreth orës 19.00, ka dalë nga shtëpia e tij që ndodhet në afërsi të qendrës “Globe” dhe ka shkuar tek një supermarket, ku ka blerë disa gota me kos. Pasi ka dalë prej andej, ka konstatuar se po ndiqej nga tre persona civilë dhe për t’ju shmangur atyre për disa orë ka lëvizur në rrugë të ndryshme, në afërsi të vëndbanimit të tij.

Ndërsa ishte duke ecur në rrugë, kanë ardhur dy civilë që sipas ankuesit e kanë kapur nga kyçet e duarve, duke i përkulur kokën dhe njëri prej tyre e ka qëlluar me gju në anën e djathtë të fytyrës tek syri disa herë. I dëmtuari E. A., i ka pyetur se kushin ishin, ndërsa personat i janë përgjigjur “se ishin Policia” ndonëse nuk i kanë treguar disnaktivin e kërkuar prej tij. Më pas personat pa uniformë policie, e kanë shtrirë me forcë për tokë shtetasin E. A., duke i vendosur prangat në duar dhe qëlluar me shqelma në pjesë të ndryshme të trupit si dhe përdorur fjalë ofenduese. Punonjësit e policisë kanë transportuar të arrestuarin E. M., në mjediset e Komisaritit të Policisë nr.2 Tiranë dhe prej andej në Drejtorinë e Policisë.

Në përgjigjen drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit më datë 22.09.2015, me shkresën nr.4815/1, Komisarati i Policisë nr.2 Tiranë informon se shtetasi Erald Alimehmeti është arrestuar për veprën penale “*Kundërshtim i punonjësit të policisë të rendit publik*”, “*Kanosje për shkak të detyrës*” dhe “*Prodhim dhe mbajtje pa lejë të armëve luftarake*”, parashikuar nga nenet 236/2, 238 e 278 të Kodit Penal, kjo dhe për faktin se gjatë arrestimit i është gjetur një armë zjarri, tip pistolete.

Konstatime dhe përfundime

Duke parë në tërësi veprimet e kryera nga punonjësit e NJ.F.P.O-së të Drejtorisë së Policisë Tiranë, të cilët kanë marrë pjesë në arrestimin e shtetasit E. A., konstatohet se prej tyre ka shkelje të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, të cilat konsistojnë në kapërcim të kompetencave në ushtrimin e detyrës dhe konkretisht:

Nenin 105 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: “*Etika e Policisë së Shtetit përmban parimet dhe normat që rregullojnë raportet e sjelljes, qëndrimin, plotësimin të detyrave dhe komunikimit të punonjësit të*

Policisë për të vepruar në përputhje me ligjin, me standartet më të larta profesionale në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në respektim të dinjitetit njerëzor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

Nenin 133 pika 1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura”.*

Në rrethanat e paraqitura nga ana e të arrestuarit Erald Alimehmeti nuk është përdorur forcë, por përkundrazi kanë qënë punonjësit e policisë të cilët pas realizimit të arrestit të tij dhe vendosjes së prangave në duar, kanë vazhduar ushtrimin e saj duke qëlluar me grushte e shqelma në pjesë të ndryshme të trupit. Me këto veprime punonjësit e policisë janë përgjegjës sipas nenit 211 të “Rregullores së Policisë së Shtetit”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.750 datë 16.09.2015, ku thuhet: *“Punonjësi është përgjegjës për përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës, nëse: 1.Përdor forcën në intesitet dhe kohë, mbi masën që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim dhe të ligjshëm të Policisë”.*

Këto veprime bien nesh dhe me nenin 102 të Rregullores së Policisë së Shtetit ku thuhet: *“Masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, të drejtat dhe interesat që vihen në rrezik dhe/ose cënohen si dhe nuk duhet të përbëjnë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur”.*

Përdorimi i fjalëve fyese nga punonjësit e policies përbën shkelje të sjelljes dhe etikës në kryerjen e detyrës, e cila bie ndesh me nenin 94 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku thuhet: *“Punonjësi i Policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave”.*

Nga ana tjetër mosparaqitja e dokumentit dhe medaljonit zyrtar të identitetit nga punonjësit e policisë gjatë arrestimit, bie ndesh me pikën 2 të nenit 98 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet: *“Punonjësi i policisë pajiset me dokumentin dhe medaljonin zyrtar të identitetit, të cilat i paraqet në çdo rast të kryerjes së detyrës...”*

Duke respektuar detyrën fisnike dhe të vështirë të punonjësit të Policisë së Shtetit dhe sidomos të NJ.F.P.O-së duhet të theksojmë dhe faktin se shteti ju ka dhënë atyre përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve të policimit në respekt të plotë me shtetin ligjor. Policimi konsiderohet si manifestim i dukshëm i autoritetit shtetëror, ku ndër detyrat më të rëndësishme të saj është dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari-dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Do të sugjerim që nga ana e punonjësve të policisë në përgjithësi dhe NJ.F.P.O-së në veçanti si struktura policore që marrin pjesë dhe në arrestimin e personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale, duhet të bëhet kujdes në ushtrimin e detyrës me profesionalizëm dhe ndershmëri. Kjo për faktin se gjatë trajtimit të ankesave të shtetasve të ndryshëm drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, janë ngritur pretendime se Policia e Shtetit iu ka atribuar atyre padrejtësisht vepra penale të pa kryera siç mund të jenë *“Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”* me fjalë për ta penguar të kryejë detyrën apo duke ushtruar dhunë, *“Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë të rendit publik”* etj, të cilat i ka pasaqyruar në Raport e Shërbimit.

Është detyra e organit procedues për të verifikuar pretendimet dhe provuar kryerjen e veprave penale që i atribohen në rastin konkret shtetasit E. A., për të cilat dhe Policia e Shtetit ka kryer "Arrestin në flagrancë".

Jemi të mendimit se sjellja korrekte dhe etika profesionale e punonjësit të Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së detyrës, jo vetëm do të minimizojë reagimin e kundërligjshëm të qytetarëve, por edhe do të rritë më tepër besimin dhe respektin ndaj tij.

Rasti i përmëndur më sipër duhet të bëhet objekt i një analize në strukturat e Policisë Vendore, me qëllim marrjen e masave që shkeljet e konstatuara të mos përsëriten në të ardhmen.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike"* dhe në bazë të nenit 21 gërma "c" të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *"Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen"*,

REKOMANDOHET

"Fillimi i hetimit te procedimit disiplinor ndaj punonjësve të policisë së NJ.F.P.O-së pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë të cilët, më datë 10 Gusht 2015, kanë kryer arrestimin e shtetasit E. A."

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

- 1.Ankesa e shtetases V. A., datë 21.08.2015.
- 2.Proces Verbal I marrjes së deklarimeve të shtetasit E. A., datë16.09.2015.
- 3.Shkresa nr.K2/V23-5 datë 29.09.2015, drejtuar Drejtorit të Policisë Tiranë.
- 4.Shkresa nr.K2/V23-7 datë 28.10.2015, drejtuar Drejtorit të Policisë Tiranë dhe për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- 5.Shkresa nr.4815/1 datë 22.09.2015, e Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë.
- 6.Shkresa nr.13699/5 datë 05.11.2015, e Drejtorisë së Policisë Tiranë.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

K O M I S I O N E R I

Konc.&Dakt.P.A.
Tiranë më 25.11.2015

Arben SHKËMBI

